



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Eglantina Gjermani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Hekuran Hoxhalli, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Dritan Bici, Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Agim Bregasi – Drejtor (KU)

Fatmir Elezi - Inxhinier KESH

Anisa Pina – Specialiste (KU)

Aldo Xherahu – Fotograf (KU)

Brikena Jazxhi - Specialiste në Drejtorinë e Borxhit në MEF

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi dhe përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Këtë javë do të zhvillojmë disa mbledhje. Së pari, keni ndonjë vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Jo.

Në rendin e ditës së sotme kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31. 12. 2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”. Relator është zoti Suli. Të ftuar kemi zonjën Çinari, zotin Bregasi, zotin Elezi, zonjën Pina, zotin Xherahu, si dhe zonjën Brikena Jazxhi, specialiste në Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Zoti relator, si fillim fjalën e kanë përfaqësuesit e ministrisë dhe më pas vazhdojmë me pyetjet apo komentet.

Nesër do të diskutojmë për ndryshimin e një neni në ligjin e gazit. Jam pak i çuditur, sepse para dy javëve ndryshuam diçka. Brenda kësaj jave duhet të konkludojmë me propozimet që do t’i bëjmë Komisionit të Ekonomisë për projektbuxhetin për pikat që kemi diskutuar. Kështu që, nëse keni merake, duhet t’i parashtroni në komision në mënyrë që të propozimet përfundimtare që do t’i bëjmë Komisionit të Ekonomisë të pasqyrojmë shqetësimet tona. Për një pjesë të ndryshimeve kemi rënë dakord, kurse për një pjesë tjetër jemi në diskutim. Nëse keni diçka tjetër që mendoni se duhet të shtohet, ju lutem kontaktoni me sekretarinë e komisionit. Pa humbur kohë, fjalën e kanë përfaqësuesit e ministrisë për të na shpjeguar marrëveshjen.

Dorina Çinari – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ne kemi sjell sot për ratifikim marrëveshjen ndryshuese të marrëveshjes së huas të datës 31. 12. 2012, nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin me 12 milionë dollarë të projektit të rehabilitimit të digave të hidrocentralit të Komanit.

Marrëveshja ndryshuese konsiston në përdorimin e shumës së mbetur nga kjo shumë huaje, që është rreth 6,58 milionë euro, për t’iu bashkuar fondit prej 12 milionë të Bankës Botërore dhe për të aktivizuar projektin e rehabilitimit të portave të

hidrocentralit të Komanit. Pra, marrëveshja synon përdorimin e fondeve të mbetura nga huaja origjinale në masën 6, 58 milionë euro për t'u kaluar në projektin e rehabilitimit të portave të hidrocentralit të Komanit.

Eduard Shalsi – Dakord.

Zoti Bregasi, keni ndonjë shpjegim për kolegët që nuk e dinë se për sa porta bëhet fjalë?

Agim Bregasi – Atëherë, siç e tha edhe zëvendësministria, kjo është një marrëveshje e detyrueshme për shumë arsye:

Së pari, nga tenderët e mëparshëm dhe punimet që janë kryer në hidrocentralin e Komanit kanë tejpruar rreth 6 milionë euro dhe, së dyti, kemi një kusht nga Banka Botërore në marrëveshjen që miratuar para dy muajve, rreth datës 10 apo 11 shtator, për 12 milionë të tjera për rehabilitimin e portave të hidrocentraleve të Komanit dhe Fierzës, që pa u miratuar edhe kjo mbetje e financimit, nuk fillon lëvrimi.

Natyrisht, kjo është në kuadër të një projekti të madh të sigurisë së digave. Deri tani janë aktivizuar rreth 82 milionë euro për punimet në Fierzë dhe Koman. Marrëveshjes që po mbrojmë sot i shtohen edhe 12 milionët, që u miratuan para dy muajve, të cilat do të shkojnë për rehabilitimin e portave të punës dhe të remontit në hidrocentralet e Komanit dhe të Fierzës. Është po ai financim që është miratuar dikur, por i ndryshon destinacioni. Ka qenë në përgjithësi për digat në të gjithë atë mori punimesh që janë bërë në digën e Komanit, në këmbën e digës dhe në tunelet e shkarkimeve, kurse tani është e domosdoshme që të bëhet rehabilitimi edhe i portave. Janë dy tunele që duhen rehabilituar në Koman dhe dy në Fierzë, respektivisht 3-i dhe 4-a, të cilët kanë pasur probleme për shkak të kohës së gjatë të shfrytëzimit. Hidrocentrali i Fierzës ka rreth 40 vjet në punë, kurse Komani rreth 30 vjet, kështu që amortizimi ka bërë të vetën dhe mundësia e ndërhyrjeve, por edhe e financimit nuk ka qenë e mundur të realizohej deri tani.

Për fat, në këtë marrëveshje nuk kërkohet shtesë fondesh dhe nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit. Ministria e Financave është përgjigjur pozitivisht sepse nuk ka ndikime as në buxhetin e shtetit dhe as në atë të KESH-it. Pra, është një financim që i ndryshojmë vetëm destinacionin.

Pika e dytë ka të bëjë me shtyrjen e afatit deri në dhjetor të vitit 2021, që të mos vijmë përsëri për të kërkuar shtesë kohe.

Rehabilitimi i tuneleve 3 dhe 4 Fierzë dhe 3 dhe 4 Koman, por edhe përfundimi i rehabilitimit të turbinës së 4-t në Koman kërkon edhe këtë mbështetje me këtë financim që do të miratojmë sot.

Siç thamë edhe në shtator, në Koman janë rehabilituar 1-i, 2-i dhe 3-i, kurse tani kërkohet miratimi për rehabilitimin e 4-s.

Me këtë financim ne përfundojmë rehabilitimin e hidrocentralit të Komanit me portat e punës dhe shkarkimit të tuneleve 3 dhe 4, si dhe turbinën e 4-t (4 turbina ka) dhe njëkohësisht edhe tunelet e shkarkimit të Fierzës 3-i dhe 4-a, që, siç e dimë, shpesh është bërë problem edhe për menaxhimin e prurjeve të mëdha në hidrocentralin e Fierzës, sepse ai tunel nuk është hapur që nga provat që u bënë në vitet '78-'80 kur është në punë.

Në përgjithësi kjo është situata për këtë financim.

Sa për informacion shtesë, është një projekt shumë madhor që ka filluar implementimin që para disa viteve dhe për fat tani jemi në përfundim. Më pas do të kërkohet vetëm rehabilitimi i dy turbinave të Fierzës, sepse dy janë bërë, dhe portave të shkarkimit të Vaut të Dejës, që, në fakt, nuk janë aq problematike sa janë Komani dhe Fierza. Me këtë financim rehabilitimi i hidrocentralit të Komanit mbyllet përfundimisht dhe Fierza vihet në kushte optimale për një shfrytëzim sa më racional dhe pa rrezik të tuneleve të shkarkimit.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bregasi!

Ka pyetje?

Po, relatori.

Rakip Suli – Duhet të jemi korrektë me shifrat, sepse regjistrohen. Nuk janë 12 milionë dollarë, por 12 700 000 euro.

Këtu është cilësuar që i gjithë aktiviteti i planifikuar është realizuar 100%, por duhet të jemi të kujdesshëm, sepse kur themi 100%, do të thotë që diferenca e mbetur prej 6 128 224 euro, nuk do të shkojë atje, pavarësisht se më poshtë e keni sqaruar, përfundimi i digave dhe më pas me numra, 1, 2, 3 ...

Mendoj që duhet të jemi pak më të qartë gjatë diskutimeve, sidomos me shifrat. Nuk janë 12 milionë dollarë, por 12 700 000 euro. Kjo është ratifikuar për herë të parë në datën 31. 12. 2012 dhe jo 2013-n.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi i marrëveshjes për diferencën e mbetur prej 6 128 224 euro është shtyrja e afatit dhe përdorimit të fondit.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka pyetje tjetër nga ndonjë koleg?

Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Shihemi nesër në orën 11:00 për ligjin e gazit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA